



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1025/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Bashkimi Projekt” SH.P.K., me NRB:70608464, rruga “Ahmet Korenica”, B1-C16, hyrja 1A, lokali numër 3-4, Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga XH.T. avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Sallabaja” SH.P.K., me NRB:810799504, me seli në Podujevë, përfaqësuar sipas autorizimit nga V.I. avokat nga Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.416/23 të datës 17.04.2023, të Përmbaruesit Privat Irfan I.Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 29.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “Sallabaja” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.416/23 të datës 17.04.2023, të Përmbaruesit Privat Irfan I. Kërçagu.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Bashkimi Projekt”, ka lëshuar urdhër me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.0036 të datës 22.09.2020, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj shumën prej 50,000.00 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, në të kundërtën përmbarimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë bankare të zyrës përmbarimore, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare përmbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur ka theksuar se propozimi për përmbartim rezultoi të jetë i iniciuar në kuptim të dokumentit të besueshëm faturës siç parashihet në nenin 29 par. 1.3 i LPP-së, por kreditori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për dorëzimin e kësaj fature, së këndejmi fatura nuk është e nënshkruar as e vulosur nga drejtori i debitorit, prandaj ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm mbi të cilin të mund të zhvillohet procedura përmbartimore. Më tutje ka shtuar se në faturë nuk është i paraparë afati për kryerjen e detyrimit dhe dështimi i plotësimit të këtij elementi është në kundërshtim të plotë me nenin 30 të LPP-së sepse është iniciuar procedura përmbartimore pa u bërë e kërkueshme kredia, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbartimor P.nr.416/23 i datës 17.04.2023.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit për arsye se fatura i është dorëzuar në origjinal dhe debitori është i njoftuar me kohë me obligimet dhe ka qenë i vetëdijshëm për obligimin që e ka ndaj kreditorit. Ka shtuar se fatura është e rregullt sipas përshkrimit dhe është dokument i besueshëm konform dispozitës së nenit 29 par. 1.3 dhe 36 të LPP-së. Më tutje ka shtuar se kreditori dhe debitori kanë lidhur kontratë më datë 02.12.2019, për kryerjen e punëve ndërtimore për ndërtimin e objektit Qendra Wellness dhe SPA në Podujevë, andaj fatura është lëshuar duke u bazuar në kryerjen e punëve të bëra nga kreditori në vendin e cekur në kontratë. Ka theksuar se në faturë fare nuk ceket data e përmbushje së obligimit, por duke u bazuar në nenin 295 të LPP-së, kreditori mund të kërkojë menjëherë përmbushjen e detyrimit, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr. 416/2023 i datës 17.04.2023, të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.416/2023 të datës 17.04.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Irfan I. Kërçagu, e ka pranuar me datë 13.06.2023, e cila vërtetohet nga fletëkthesa për dorëzim personal të përmbartuesit privat që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datë 22.06.2023.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose urdhrin përmbartues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se: *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.416/23 të datës 17.04.2023, e ka pranuar me datë 13.06.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 14.06.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 20.06.2023.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 22.06.2023 cila datë vërtetohet sipas vulës së postës me numër rekomande R 2917167, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 2 (dy) ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1025/23, datë 29.09.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate